

RENDI I DITËS

**Projektvendim "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 03, të paraqitur në
KOZ në datën 12.02.2022".**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, E.Meta, A.Llano
- **Parti Politike:** LRE

Z. I. Rusmali: Mirë, atëherë fillojmë seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 3, datë 12.02.2022, me objekt "Kundërshtimin e vendimit nr.72, datë 12.02.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve". Prezentë në sallë sot janë përfaqësuesit e ankuesit, Lëvizja e Re, sikurse u prezantuan në seancën paraprake dhe. Janë përfaqësuesit e administratës dhe anëtarët e KAS-it, kolegu Bele, do të jetë me ne në vazhdim online, por do të jetë prezent gjithsesi në vendimmarrjen tonë. Cili nga ju do ta marrë fjalën për të bërë prezantimin e çështjeve që ju doni të shtroni para nesh?

Znj. E. Nano, juriste e LRE-së: Përshendetje! Lëvizja e Re ka bërë dorëzimin e dokumentacionit për regjistrim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe menjëherë pas kësaj ka bërë dhe regjistrimin, dorëzimin e dokumentacionit për regjistrimin e kandidatëve të saj, dy prej tyre, në Dibër dhe në Durrës, në datën 8 shkurt. Pra, një ditë para përfundimit të afatit përfundimtar për dorëzimin e


**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.02.2022*

kandidaturave pranë KQZ-së. Në datën 12 shkurt, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë vendimin për mosregjistrimin e kandidatit të Lëvizjes së Re për qytetin e Durrësit me arsyetimin se, është në kundërshtim të nenit 68, pika 3, por në këtë pikë e marrim si shkelje nga ana e KQZ-së sepse dokumentacioni i Lëvizjes së Re për kandidatin e Durrësit është dorëzuar i plotë sikurse vërtetohet edhe nga procesverbali i dorëzimit të dokumentacionit. Do doja të rendisja faktet për këtë çështje, duke lexuar kërkesën ankimore. Në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve thuhet se “Subjekti zgjedhor nuk disponon mandat në Këshillin Bashkiak Durrës, vetëdeklarimi i zonjës Alneida Nexhmi Rroshi, anëtar i Këshillit Bashkiak Durrës mbështet kandidatin e Lëvizjes së Re, nuk përmbush kushtin ligjor të përcaktuar në pikën 3, të nenit 68 të Kodit Zgjedhor”. Në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar neni 63, pika 3, thuhet “Për qëllim të këtij neni, partia politike ose koalicioni paraqet një vërtetim me shkrim të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit, apo njësia e qeverisjes vendore ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit ose të organit të njësisë së qeverisjes vendore, në bazë të vetëdeklarimit të zotëruesve të mandateve për përkatësinë në partinë politike në institucionin përkatës”. Në këtë pikë nuk thuhet se zotëruesi i mandatit të këshillit bashkiak, t’i përkasë subjektit zgjedhor, të cilin ai mbështet, por që zotëruesi i mandatit bashkiak të ketë të paktën 6 muaj që zotëron këtë mandat. Pika 2. KQZ me anë të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.50, datë 10.02.2022 ka bërë regjistrimin e kandidatit të Lëvizjes së Re për Bashkinë Dibër, zotin Dritan Hajri Torba, i cili ka paraqitur të njëjtin dokumentacion, si edhe kandidati për kryetar bashkie i Durrësit, zoti Jonid Robert Nano, çka përbën standard të dyfishtë në shqyrtimin e dokumentacionit për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie, në zgjedhjet e datës 6 Mars 2022. Në zbatim të pikës 10 të vendimit të Komisionit


*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.02.2022**

Rregullator me nr. 2, datë 22.01.2022 “Për miratimin e disa afateve proceduriale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Durrës, Shkodër, Dibër, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje që do të zhvillohen në datën 6 Mars 2022”, Lëvizja e Re ka paraqitur kërkesën për regjistrimin e kandidatit të saj për zgjedhjet e pjesshme, për Bashkinë Durrës, më datë 08.02.2022, me numër protokolli 573, e vërtetuar kjo me procesverbalin e dorëzimit të dokumentacionit të kandidimit, modelin 08. Në pikën 10 të këtij vendimi përcaktohet se afati brenda të cilit bëhet dhe verifikimi i dokumentacionit është 24 orë nga paraqitja. Në rast të parregullsive, KQZ njofton subjektin dhe i kthen dokumentacionin për plotësim. Dokumentacioni i plotësuar i riparaqitet KQZ-së jo më vonë se 24 orë. KQZ merr vendim jo më vonë se 24 orë nga riparaqitja e dokumentacionit. Përsa më sipër KQZ duhet të kishte njoftuar për parregullsitë e pretenduara në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati i LRE-së për kryetar bashkie në qytetin e Durrësit, brenda 24 orëve. Pra, në datën 9 shkurt 2022 sipas pikës 10 të vendimit të datës 22.01.2022. Pra, do doja ta theksoja pak pikën 10 të këtij vendimi, sepse ky vendim përcakton edhe afatet kur KQZ-ja duhet të kishte njoftuar kandidatët për parregullsi. KQZ-ja nuk është këtu për të ndaluar apo për të lejuar kandidatët, të cilët duhet të konkurrojnë apo jo. KQZ-ja është këtu me rolin e saj si rregullator. Pra, KQZ-ja ndihmon kandidatët që të plotësojnë dokumentacionin për kandidim. Pra, nuk është këtu për të ndaluar, por është për të ndihmuar, prandaj dhe vendosen këto afate. KQZ-ja duhet të kishte njoftuar kandidatin për parregullsinë që kishte vërejtur 24 orë brenda afatit, domethënë nga paraqitja e dokumentacionit, dhe në qoftë se Lëvizja e Re apo kandidati i Durrësit nuk i plotësonte këto mangësi që KQZ-ja ka hasur në dokumentacion dhe nuk i riparaqiste, atëherë po, kishte të drejtën që të mos e regjistronte kandidatin, por Lëvizja e Re nuk ka marrë asnjë informacion, nuk i është dërguar asnjë shkresë, asnjë mesazh, asnjë e-mail për

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.15.02.2022

parregullsitë që administrata e KQZ-së ka hasur në dokumentacionin e Lëvizjes së Re. Kjo ishte ajo që doja të thoja. Duhet marrë parasysh që kandidati i Dibrës ka po të njëjtin dokumentacion, siç ka dhe kandidati i Durrësit. Pra, nuk ndryshojnë përveç emrit të këshilltarit që është në Dibër, nuk ka asnjë ndryshim tjetër, dhe ky është standard i dyfishtë, një kandidat e regjistron dhe një kandidat tjetër nuk e regjistron. Faleminderit!


Z. A. Galdini, përfaqësues i LRE-së: Mundem?

Z. I. Rusmali: Po, patjetër!

Z. A. Galdini, kryetar i Partisë LRE-së: Unë nuk jam jurist, unë jam ekonomist në profesion, por po përpiqem të rendis disa mendime që më vijnë për këtë çështje. Arsyeja përse partitë politike ekzistojnë është sepse ato duhet t'u ofrojnë qytetarëve kandidatë dhe alternativa. Partitë politike e tregojnë vetveten nëpërmjet garave. Në pluralizmin politik ne kemi krijuar një institucion që administron garat për të garantuar lirinë dhe barazinë e tyre. Nuk po flasim për pjesën tjetër që e shkatërron, e minon barazinë e garës, por po flasim për atë që është elementi minimalist, pra prezenca në garë. Lëvizja e Re ka zbatuar të gjitha afatet ligjore dhe proceduriale që kërkohen nga KQZ-ja dhe nga Kodi Elektorale, dhe të gjitha afatet janë këtu pikërisht për ta garantuar këtë barazi të garës. Është debatuar gjatë në Shqipëri mbi padrejtësitë që shkakton në raport të kësaj barazie ky Kod Zgjedhor që ne kemi, por këtu nuk jemi për të diskutuar për natyrën e Kodit, por jemi për të diskutuar për zbatimin e tij. Afatet që janë parashikuar në Kod dhe nga vendimet e KQZ-së janë për të lehtësuar procesin drejt barazisë së garës, kandidatëve dhe partive politike. Prandaj kërkohet 24 orë komunikim me

Zbardhi materialin audio

Lorena KONJA




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.15.02.2022

kandidatët dhe me partitë politike që nëse ka parregullsi, nëse ka mungesa, nëse ka shkelje ligjore, kandidatëve dhe partive t'u jepen mundësitë që ato të rregullojnë dokumentacionin dhe ato kanë dhe 24 orë të tjera shtesë për ta plotësuar këtë dokumentacion, bëhet fjalë për 48 orë në dispozicion të kandidatëve dhe partive politike. Përderisa ligji parashikon dy mënyra, pra mbështetjen nga një këshilltar, ose mbështetjen nga firmat e qytetarëve, kjo do të thotë që përzgjedhja dokumentacionale është një përzgjedhje taktike. Në momentin që administrata e KQZ-së nuk e njofton partinë politike, se përzgjedhja që ajo ka bërë nuk është e duhura, atëherë i ka mohuar mundësinë partisë politike që ajo të japë rrugën tjetër të mbështetjes së kandidatëve, dhe këtu nuk ka pikë rëndësie i kujt partie është këshilltari që ka firmosur për kandidatin, sepse pika 3 e thotë qartë që duhet vetëm 6 muaj mandat për zotëruesin e këtij mandati, pra për këshilltarin. Në rast se do t'i shkonim logjikës së përkatësisë politike, i bie që edhe qytetarët të jenë mbështetës, sepse si rregull një këshilltar është mbështetës i kandidimit, pra nuk ka asnjë detyrim ligjor që të jetë anëtar i partisë të kandidatit që do të futet në garë, se përndryshe atëherë me po të njëjtën logjikë do duhet që dhe qytetarët të ishin anëtarë të partisë, por qytetarët që firmosin, që japin firmat mbështetëse për një kandidat, japin aprovimin për kandidatin që ai të ketë të drejtë të konkurrojë. Pra bëhet fjalë për të drejta minimaliste, për të drejtën për të konkuruar. Domethënë ajo që i ka mohuar kësaj radhe KQZ-ja me këtë vendim të padrejtë, ka mohuar të drejtën e një kandidati dhe të një partie politike për të konkuruar. Pra, duhet ta shohim në këtë dritë këtë argument, dhe pastaj pjesa tjetër që unë e konsideroj absurde dhe paradoksale është se ne kemi për një parti politike, dy kandidatët e të njëjtës parti politike, me të njëjtin, absolutisht të njëjtin dokumentacion, me të njëjtën dinamikë ligjore, dhe po nga i njëjti institucion, njëri kandidat miratohet dhe kandidati tjetër rrëzohet. Prandaj ju drejtohem me respekt dhe vlerësim që ta

Zbardhi materialin audio

Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.02.2022*

korrektojmë këtë padrejtësi që ndoshta mund të jetë dhe gabim procedural, pra nuk e paragjykojmë, por kërkojmë që të korrektohet ky vendim dhe kandidati ynë, Jonid Nano të regjistrohet në listën e kandidatëve për kryetar bashkie në qytetin e Durrësit. Faleminderit!


Z. I. Rusmali: Faleminderit! KQZ-ja ka ndonjë prapësim, ndonjë shtesë për të bërë deri tani?

Z. Y. Merkaj: Jo gjatë shqyrtimit administrativ të kërkesës për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, zotit Jonid Nano, dokumentacioni ka qenë i plotë, por ka pasur ca pasaktësi në përmbajtje. Domethënë KQZ-ja nuk ka qenë në dijeni që ky se ka pasur mandatin, është verifikuar dhe është vërtetuar vetëm gjatë mbledhjes, që ky mandat nuk i takon Partisë Lëvizja e Re, por i takon Partisë Socialiste. Dokumentacioni në përmbajtje, në formë ka qenë i plotë, i saktë dhe ne nuk kishim si t'ia kthenim kur nuk e dinim përmbajtjen. Gjatë mbledhjes pastaj, një nga përfaqësuesit e partive politike ngriti pretendimin që ky anëtar i Këshillit Bashkiak të Durrësit nuk i takon Partisë LRE, por i takon një partie tjetër, dhe këtu pastaj u vendos që, bile u shty dhe mbledhja, u kërkua dhe një vërtetim tjetër nga Këshilli Bashkiak Durrës, i cili e solli më të plotë me përkatësinë politike që zotëronte mandatin e anëtarit të këshillit bashkiak.

Z. L. Braho: Për rastin e Dibrës, ai normalisht është miratuar nga KZAZ-ja. Atje si është proceduar me mandatin e këshilltarit?

Z. Y. Merkaj: Për bashkitë, të cilat përbëhen nga një KZAZ, vendimi për regjistrimin e kandidatëve e merr KZAZ-ja. Për bashkitë që kanë më shumë se një

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.02.2022*

KZAZ, i merr KQZ-ja. KZAZ-ja ka vendosur që ta miratojë një subjekt zgjedhor të LRE-së. Në qoftë se nuk ka ankim në KAS kundër vendimit të KZAZ-së, ai ngelet i pandryshuar.


Z. I. Rusmali: Pyetje tjetër?

Z. E. Çefa: Unë kisha një pyetje. Në fakt ka të bëjë me një opinion mbase. Domethënë, meqenëse ju interpretuat pikën 3 të nenit 68, të ligjit duke favorizuar sigurisht kërkesën tuaj për regjistrim. Unë do doja një opinion nga ju për mënyrën e interpretimit të pikës 2, të nenit 68 të ligjit, sepse unë besoj që dispozitat duhet t'i shohim të harmonizuara me njëra-tjetrën dhe s'mund t'i analizojmë veç e veç.

Z. I. Rusmali: Po, faleminderit! Kush do përgjigjet nga ju? E kërkon nga ankuesi përgjigjen anëtari i KAS-it.

Z. A. Galdini, kryetar i Partisë LRE-së: Meqë është pjesë e njërës prej mundësive, pra janë dy zgjidhje që ka lënë Kodi Zgjedhor. Pra, ose mbështetjen nga 1% e qytetarëve me firmat mbështetëse, ose nga një këshilltar, i cili ka një mandat 6 mujor. Jemi në të njëjtën logjikë. Pra, janë dy mundësi që u janë dhënë kandidatëve për të konkurruar, dhe gjithmonë bëhet fjalë për mbështetje. Nuk bëhet fjalë për anëtarësim, nuk bëhet fjalë për përkatësi politike. Në zgjedhjet e 25 prillit ne jemi e vetmja parti politike që jemi regjistruar këtu në këtë institucion me 6432 firma të qytetarëve dhe mbështetësve dhe ju si siguroj që jo të gjithë kanë qenë anëtarë të partisë sonë. Pra, jemi brenda po së njëjtës logjikë. Pra, mbështetet një kandidat për të drejtën elementare, për të konkurruar, për të garuar, dhe kaq. Ndërkohë unë po ju them, për informacion, ne kemi punuar në të dyja drejtimet, pra dhe për

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.15.02.2022

mbledhjen e firmave mbështetëse edhe për kandidatin. Kandidatja që ka firmosur, ka shprehur vullnetin e lirë për të mbështetur Jonid Nanon për arsyet që ajo i gjykon të drejta. Këtu nuk ka pikë rëndësie përkatësia e mbështetëses. Për arsyet që ajo i konsideron të drejta ajo e ka mbështetur kandidatin tonë. Kjo nuk kërkon nga ajo që ajo të jetë anëtare e partisë sonë, as të jetë zotëruese e mandatit prej partisë sonë. Megjithëse është e ftuar nëse dëshiron t'i bashkohet partisë sonë, por ne nëse do të ishim njoftuar brenda 24 orëve për këtë, le të themi, parregullsi, ose mosqëndrim me ligjin, mospërputhshmëri me ligjin, ne mund të kishim sjellë firmat mbështetëse të qytetarëve. Pra, na është mohuar e drejta për t'i konsumuar të dyja alternativat.


Z. E. Çefa: Po, në vazhdim të kësaj, domethënë, pra ju po pretendoni që firmat i kishit apo ishit në gjendje t'i mblidhnit në rast se Komisioneri do t'ju jepte një 24-orësh kohë tjetër, apo jo?

Z. A. Galdini, kryetar i Partisë LRE-së: Ne kemi qenë prej dy javësh e gjysmë me të gjithë strukturën tonë në një proces mbledhjeje firmash, dhe besoj kemi qenë shumë afër përmbylljes së numrit që kërkohet, pra 2600 firmave. E gjithë struktura jonë ka qenë e fokusuar se duke qenë se këto janë zgjedhje të pjesshme, për ne ishte më e lehtë sepse të gjithë njerëzit që po punonin u fokusuan në Durrës. Ne ishim shumë afër kësaj gjëje, por duke qenë se këshilltarja për arsye që ajo i quan të drejta, ka vendosur ta...

Z. E. Çefa: Ka vendosur një alternativë tjetër për t'u regjistruar, e kuptova! Mirë, faleminderit!

Zbardhi materialin audio

Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.02.2022*


Z. I. Rusmali: Këtë vendimin e regjistrimit të kandidatit të Dibrës e dispononi juve?

Z. A. Galdini, kryetar i Partisë LRE-së: Jo! E kemi kërkuar por KZAZ-ja nuk na e ka vënë në dispozicion. E kemi kërkuar dy ditë rresht, në fakt, por nuk na e kanë vënë në dispozicion.

Z. I. Rusmali: KQZ-ja e disponon kopje të këtij vendimi? Mund të na e vini ne në dispozicion një kopje të këtij vendimi? Në rregull! Në kërkesë ankimore ankuesi ngre një pretendim lidhur me mosrespektimin e afatit për korrigjimin e dokumentacionit, që parashikohet nga vendimi i Rregullatorit. Ju keni ndonjë qëndrim lidhur me këtë pretendim?

Z. Y. Merkaj: Atëherë, Partia LRE është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022 dhe ka paraqitur kërkesën për regjistrimin e kandidatit Jonid Nano në Bashkinë Durrës. Bashkëlidhur kërkesës është dhe dokumentacioni, këkesa e partisë politike për regjistrimin si kandidat për kryetar të bashkisë, në Bashkinë Durrës. Kopje të dokumentacionit të identifikimit të kandidatit për kryetar bashkie, deklarimin e llogarisë bankare të posaçme të kandidatit model 03/1 të udhëzimit, deklarata e kandidatit ku deklaron të gjitha elementet e përcaktuara në shkronjën “b” dhe “c”, të nenit 72 të Kodit Zgjedhor. Vërtetimi nr.1043 të protokollit, datë 02.02.2022, nënshkruar nga kryetari i Këshillit Bashkiak Durrës. Për këtë bëhet fjalë. Jetëshkrimi i kandidatit, formulari i vetëdeklarimit dhe procesverbali i dorëzimit të dokumentacionit. Të gjithë këto 8 dokumentet që ka paraqitur për ne ishin të plota, dhe nuk kishim sesi t’ia kthenim kur ai kishte paraqitur 8 dokumentet që ne kërkonim. Gjatë seancës pastaj për

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.02.2022*

shqyrtim doli që ky vërtetim me nr. 1043, datë protokoll 02.02.2022, i nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Durrës nuk ishte vërtetimi që ne kërkonim, pasi nuk zotëronte mandat.

Z. I. Rusmali: Nuk menduat që në këtë moment duhet t'i njihnit të drejtën për të bërë korrigjimin e dokumentacionit paraqitur, sikurse parashikon vendimi i Rregullatorit?

Z. Y. Merkaç: Thjesht bëme vetëm kërkesë të Këshillit Bashkiak Durrës.

Z. I. Rusmali: Në rregull!


Znj. E. Nano, juriste e LRE-së: Ligji nuk kërkon që ju t'i drejtoheni institucionit, por t'i drejtoheni subjektit që ka paraqitur dokumentacionin, çka do të thotë që normalisht, ju paraprakisht duhet të kishit kontaktuar me subjektin dhe pastaj t'i drejtoheshit institucionit ku jeni drejtuar.

Z. A. Galdini, kryetar i Partisë LRE-së: Edhe diçka tjetër!

Z. I. Rusmali: Jo, ndoshta duhet të bëj unë një pyetje këtu për ju, pastaj ju mund të shtoni.

Z. A. Galdini, kryetar i Partisë LRE-së: Edhe formulimin e dokumentit nuk e kemi bërë ne, e ka bërë këshilli bashkiak, prandaj nuk mund të ndëshkohemi për një formulim që e ka bërë këshilli bashkiak.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.02.2022*

Z. I. Rusmali: E qartë! Pyetja që kam unë është, në seancën e shqyrtimit të kërkesave që ka zhvilluar Komisioneri, ju keni qenë prezent? Ose përfaqësuesi i subjektit?

Z. A. Galdini, kryetar i Partisë LRE-së: Kjo është një gjë tjetër që do donim ta thonim, ta shtonim. Çuditërisht ne jemi i vetmi subjekt që nuk jemi ftuar në asnjë vendimmarrje nga KQZ-ja, as në hedhjen e shortit, dhe as në diskutimin e kandidatëve dhe dosjeve të kandidatëve tanë.

Z. I. Rusmali: Praktika e administratës së KQZ-së, është që njofton subjektet apo mjaftohet me njoftimin publik për zhvillimin e mbledhjes?

Z. Y. Merkaj: Që në momentin që subjektet zgjedhore regjistrohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendosin personin, kontaktet, përfaqësuesin e partisë, si dhe adresat e e-mail-it, ose numër telefoni. Të gjitha partitë që janë regjistruar në KQZ, kanë depozituar këto të dhëna, ne i kemi kontaktuar dhe u dërgojmë e-mail, të paktën 24 orë para për zhvillimin e mbledhjes të Rregullatorit, dhe të Komisionerit.


Z. I. Rusmali: Dhe këtë gjë e keni bërë dhe për subjektin?

Z. Y. Merkaj: Nuk kemi të dhëna, as adresë e-mail-i, as numër kontakti.

Z. I. Rusmali: Ju mungojnë të dhënat?

Z. Y. Merkaj: Mungojnë të dhënat, por në faqen zyrtare të KQZ-së është publike dhe shpallet 24 orë para, rendi i ditës dhe përmbajtja.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.02.2022*

Z. A. Galdini, kryetar i Partisë LRE-së: Më falni por unë kam bërë një shkresë zyrtare ku të dhënat janë të gjitha..

Z. I. Rusmali: Të lutem! E mbaron ai e fillon ti, s'ka problem! Ju nuk i dispononi, kryetari i partisë thotë që?


Z. A. Galdini, kryetar i Partisë LRE-së: Në shkresën zyrtare që ne kemi dorëzuar që është tek dokumentacioni, nëpërmjet të cilit është regjistruar subjekti politik, janë numrat e telefonit, adresat e e-mail-it dhe emrat përkatës të drejtuesve të partisë, përfaqësuesit me KQZ-në, kryetarit të partisë, kandidatit. Pra, janë të gjitha të dhënat, numrat e telefonit, adresa e-mail-i dhe adresë postare.

Z. I. Rusmali: Përfaqësues i subjektit kush është në KQZ?

Znj. E. Nano, juriste e LRE-së: Atëherë dokumentet unë i kam dorëzuar vetë dorazi dhe jam deklaruar edhe si përfaqësues. Juristët kanë marrë edhe numrin e telefonit, edhe adresën e e-mail-it. Madje për hir të së vërtetës është verifikuar se cila ishte kandidatja, para se të miratoheshin pranimi i dokumenteve, dhe verbalisht unë e kam thënë vetë që është anëtare e Partisë Socialiste dhe që këtë e parashikon ligji. Sigurisht që këtë unë nuk kam si e vërtetoj, por e kam thënë këtë para juristëve. Nuk mbaj mend cila ishte zonja, e cila më pyeti, kjo është kandidate e Partisë Socialiste? Po, i kam thënë, dhe e parashikon ligji. Më fal, këshilltare!

Z. I. Rusmali: Dakord, mirë se po kalojmë jashtë pyetjes tani. Përfaqësuesi zyrtar i subjektit, kush është?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.02.2022*

Z. A. Galdini, kryetar i Partisë LRE-së: Është zonja Kristina Nano edhe zoti Jonid Nano, janë të dy së bashku, dhe të gjitha kontaktet e tyre, adresa e-mail-i, numra telefoni dhe adresë postare janë në shkresën zyrtare nëpërmjet së cilës është marrë vendimi për regjistrimin e subjektit tonë. Se janë dhe kërkesa ligjore, nuk regjistrohet subjekti nëse nuk janë të gjitha të dhënat.

Z. I. Rusmali: Dakord! Keni ndonjë pyetje tjetër?


Z. E. Çefa: Në qoftë se mundem? Për administratën fillimisht. Sa zgjedhës ka Bashkia Durrës, afërsisht, plus, minus? Thjesht për efekt të llogaritjeve të numrave që i duhen për të regjistruar.

Z. Y. Merkaç: 1% është 2600.

Z. E. Çefa: 2600 domethënë janë firmat? Tani brenda mundësive duam ndershmërisht këtë pyetje. Nëse hipotetikisht KAS-i apo KQZ-ja, nuk ka rëndësi, ju jep 24 orë kohë. I mblihdni dot 2600 firma?

Z. A. Galdini, kryetar i Partisë LRE-së: Hipotetikisht unë po ju them që në këtë moment që po flasim, e tërë struktura jonë ka të paktën 5 ditë që e ka lënë këtë proces. Ne ishim në një sforcim duke punuar, por ishim shumë afër objektivit, por ishte e gjithë struktura, sepse duhet të kuptoni që këtu bëhet fjalë për angazhime grupe njerëzish, të cilët janë në terren për të mbledhur firmat. Pra, nuk bëhet fjalë për një gjë që ti mundesh ta organizosh brenda 24 orëve kaq kollaj, me kaq

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.02.2022*

shpejtësi, në momentin që struktura tashmë është lënë e lirë që të tërhiqet në punët e saj personale.

Z. I. Rusmali: Pyetje të tjera? Ndonjë gjë për të shtuar nga administrata? S'ka! Mirë, besoj se mund ta mbyllim këtu shqyrtimin. Ju përsërisni kërkesat e paraqitura në kërkesën ankimore, apo doni të shtoni ndonjë gjë plus?

Znj. E. Nano, juriste e LRE-së: Jo, thjesht duam të bëhet regjistrimi i kandidatit të Durrësit për zgjedhjet e 6 Marsit 2022. Të njëjtën kërkesë kemi, faleminderit!

Z. I. Rusmali: Mirë, faleminderit! Atëherë ne do tërhiqemi për të marrë vendimin. Besoj në orën 13:00 duhet të jemi gati për ta shpallur atë. Do na prisni gjysmë ore.


Rifillon seanca

Ora 13:10

Z. I. Rusmali: Riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 3, të subjektit Lëvizja e Re. KAS-i në dhomë këshillimi mori vendimin, të cilin unë do t'ju lexoj, dispozitivin tani. Por, po filloj duke thënë paraprakisht që në kërkesën tuaj ankimore ka patur 3 kolona ankimi.

Kolona e parë ka lidhje me leximin e gabuar, të pikës 3, të nenit 68, nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Kolona e dytë ka lidhje me pretendimin për veprimin e një standardi të dyfishtë në vendmarrjen e administratës zgjedhore, dhe kolona e tretë ka lidhje me cenimin e së drejtës procedurale për plotësim dokumentacioni. Ne kemi mbajtur qëndrim për të tria këto çështje. Do t'i kemi të arsyetuara në vendimin tuaj, por paraprakisht po them që KAS-i është i mendimit

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.15.02.2022

që ju keni lexim të gabuar të pikës 3, të nenit 68. Sikurse KAS-i mendon që vendimmarrja sipas kompetencës së organeve të ndryshme zgjedhore, nuk krijon standard të dyfishtë. Standardi i dyfishtë krijohet nëse në procedurë ankimimi, institucioni që shqyrton ankimin, njëherë vendos bardh, herën tjetër vendos zi. Kjo gjë nuk ndodh, nuk ka ndodhur në rastin e Dibrës dhe të Durrësit, pavarësisht se keni dy vendime të kundërta. Pra, nuk ka standard të dyfishtë. Ju keni një të drejtë shumë të fortë lidhur me kolonën tuaj të tretë. Të drejtat dhe garancitë proceduriale janë aty që t'u shërbejnë subjekteve, jo që t'u mohohen subjekteve. Me këtë logjikë ne kemi marrë këtë vendim. Kemi vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore nr. 3, datë 12.02.2022, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Lëvizja e Re.

Kemi shfuqizuar vendimin e Komisionerit nr. 72, kemi vendosur për shfuqizimin e këtij vendimi nr.72, datë 12.02.2022 "Për shqyrtimin e kërkesës së subjektit zgjedhor Lëvizja e Re, për regjistrimin e kandidatit për kryetar në Bashkinë e Durrësit, zotit Jonid Robert Nano, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022" dhe rikthimin e çështjes për rishqyrtim pas kalimit të afatit për plotësimin e dokumentacionit.

Brenda 24 orëve nga shpallja e këtij vendimi, subjekti Lëvizja e Re të bëjë plotësimin e vërtetimit për zotërimin e mandatit përfaqësues sipas kërkesave të pikës 3, të nenit 68 të Kodit Zgjedhor, ose depozitimin e listës me nënshkrimet mbështetëse të zgjedhësve, sipas pikës 2, të nenit 68 të Kodit Zgjedhor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij. Ky është dispozitivi i vendimit që kemi marrë ne. Me kaq e mbyllim këtë seancë dhe shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj çështjeje. Faleminderit!

Vendimi nr. 8

Zbardhi materialin audio

Lorena KONJA

